



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR  
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR FIER  
ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR FIER  
GJIMNAZI “PERIKLI IKONOMI” FIER

# PLANI AFATMESËM I SHKOLLËS 2022-2026

## **HYRJE**

---

Plani afatmesëm i gjimnazit “Perikli Ikonomi” për vitet shkollore 2022-2023, 2023-2024, 2024-2025 dhe 2025-2026, hartohet mbështetur në nenet 49 dhe 50 të Rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, miratuar me urdhrin e MASR-së nr. 31, datë 28.1.2020.

Në muajin tetor 2021 është ngritur grupi qendror i punës për hartimin e këtij plani afatmesëm, i cili drejtohet nga drejtori i shkollës dhe përbëhet nga mësues, prindër dhe nxënës. Ky plan është vijimësi e planit afatmesëm të shkollës i zbatuar në vitet 2018-2022.

## MISIONI

---

Shkolla jonë është e përkushtuar për të siguruar një mjedis edukues dhe të sigurt, ku nxënësit do të zhvillojnë personalitetin, pasionet dhe interesat e tyre, duke dalë prej kësaj shkolle si qytetarë të rinj të përgjegjshëm, me mendësi qytetare europiane..

## VIZIONI

---

Shkolla jonë do të vazhdojë të ofrojë për të nxënit një kurrikul të hapur, që do të plotësojë interesat e nxënësve me anë të procesit mësimor dhe veprimtarive ndërkurrikulare. Mësuesit tanë do të vazhdojnë të shkëmbejnë mes tyre përvojat e suksesshme, si dhe iniciativa të reja. Mësuesit do të bashkëpunojnë për të hartuar dhe zhvilluar një mësimdhënie të planifikuar mirë dhe të bazuar në modele të avancuara, që lehtësojnë të nxënit dhe krijojnë mundësi për të shkëmbyer informacione dhe ide, si edhe do të mundësojnë një mjedis pozitiv dhe krijues të nxëni. Nga ana tjetër, një program mbështetës do të zhvillohet në shkollë për nxënësit me nevoja të veçanta, për të lehtësuar kalimin e tyre në një cikël më të lartë shkollimi.

Prindërit do të vazhdojnë të luajnë një rol të rëndësishëm dhe domethënës në mbështetjen e edukimit të fëmijëve si në shtëpi ashtu edhe në shkollë. Ata do ta kuptojnë që mbajtja e një linje të rregullt komunikimi dypalësh, do të bëjë të mundur një zhvillim të plotë të fëmijës si në arritjet akademike edhe në ato sociale. Për këtë, shkolla do të jetë e hapur për bashkëpunim me prindërit, të cilët do të jenë të përfshirë aktivisht në veprimtaritë mësimore dhe edukative të shkollës.

Ne i vlerësojmë përvojat e komunitetit si ndihmë të madhe për shkollën, sepse ato ofrojnë mbështetje për edukimin e nxënësve.

Shkolla jonë i mëshon më shumë edukimit të vlerave qytetare demokratike dhe europiane për nxënësit e saj.

## ANALIZA E GJENDJES

Në vitin shkollor 2018-2019 në gjimnazin “Perikli Ikonomi” u regjistruan 437 nxënës dhe në përfundim të atij viti shkollor, kur u hartua dhe u miratua edhe planin i parë afatmesëm i shkollës, numri i nxënësve ishte me 426 nxënës.

|                         | Nxënës në fillim të vitit shkollor |       | Nxënës në përfundim |       | Mësues   |       | Klasa |
|-------------------------|------------------------------------|-------|---------------------|-------|----------|-------|-------|
|                         | Gjithsej                           | Femra | Gjithsej            | Femra | Gjithsej | Femra |       |
| Viti shkollor 2018-2019 | 471                                | 243   | 426                 | 235   | 34       | 26    | 16    |
| Viti shkollor 2019-2020 | 539                                | 279   | 493                 | 265   | 34       | 27    | 18    |
| Viti shkollor 2020-2021 | 537                                | 273   | 512                 | 272   | 34       | 27    | 18    |
| Viti shkollor 2021-2022 | 531                                | 270   | 480                 | 258   | 34       | 27    | 17    |

### PIKA TË FORTA

Në renditjen e kartës së performancës për vitin 2017-2018 gjimnazi “Perikli Ikonomi” renditej i shtati ndër shkollat e mesme të DAR Fier ose gjimnazi i tretë publik më i mirë. Ndërsa në renditjen e fundit të kryer nga ZVAP Fier për vitin shkollor 2020-2021 gjimnazi ynë renditet i 6-i ndër shkollat e mesme në tërësi dhe i pari ndër shkollat e mesme (AML) publike në nivel lokal.

Nxënësit e shkollës sonë në vitet e fundit kanë fituar ndjesinë e konkurrencës dhe janë renditur në vendet e para në aktivitetet jo vetëm lokale, por edhe në nivel kombëtar (në fazën e tretë të olimpiadave kombëtare).

Megjithë rënien e përgjithshme të kontingjenteve në shkollat e ZVAP Fier, numri i nxënësve që regjistrohen në fillim të vitit shkollor ka qenë i stabilizuar.

Shkolla gjendet në një zonë të qetë ku nuk janë shfaqur probleme që lidhen me sigurinë e nxënësve, ka mjedise të përshtatshme për të plotësuar kërkesat e nxënësve me interesa të shumëllojshme.

### PIKA TË DOBËTA

Largimet e nxënësve në nivelet midis 5-10% krahasuar me fillimin e vitit shkollor, megjithëse jo masivisht drejt shkollave të tjera, por kryesisht jashtë vendit, përbëjnë një rrezik real për qëndrueshmërinë e kontingjentit të shkollës në vitet e ardhshme.

Pajisjet e teknologjisë në mësimdhënie dhe laboratorët kanë mungesa dhe janë vjetëruar, duke mos kryer plotësisht funksionin e tyre në dobi të nxënësve të shkollës.

## **PËRPARËSITË**

---

1. Rritja e interesit të nxënësve për shkollën, dëshmuar me nivel më të lartë të frekuentimit të orëve mësimore dhe klubeve shkollore, si edhe uljes së numrit të nxënësve që largohen drejt shkollave të tjera.
2. Përforcimi i imazhit të shkollës si institucion arsimor cilësor nëpërmjet arritjeve më të larta në aktivitetet konkurruese krahasuar me gjimnazet publike të ZVAP Fier dhe në rezultate më pozitive në provimet e maturës.

## BUXHETI

---

Politika e shkollës gjatë zbatimit të këtij plani afatmesëm do të jetë lehtësimi i nxënësve nga pagesat e detyruara, duke hequr menjëherë çdo tarifë për regjistrim në shkollë apo pajisje me diplomë dhe dokumente shkollore për nxënësit.

Buxheti për realizimin e veprimtarive të planit afatmesëm nuk mund të parashikohet në kushtet kur, në momentin e hartimit të këtij plani, shkolla nuk ka të ardhura dhe nuk mund të nxjerrë të ardhura.

Në mungesë të bazës ligjore dhe vendimit të bordit të shkollës aktualisht drejtoria e shkollës nuk kryen asnjë shërbim me pagesë dhe nuk grumbullon dhe qarkullon asnjë fond financiar. Për garantimin e veprimtarive fillimisht drejtoria e shkollës do të mbështetet në mundësitë aktuale që ka infrastruktura shkollore, në gatishmërinë e personelit dhe nxënësve për të punuar vullnetarisht.

Në vitin pasues do të shihet mundësia për të vendosur në një masë të pranueshme një kontribut modest financiar nga prindërit dhe të kërkohet sponsorizim për projekte të caktuara nga komuniteti dhe biznesi lokal, nga Bashkia Fier dhe institucionet e linjës.

Planifikimi i detajuar i buxhetit për veprimtari të caktuara do të kryhet së bashku me planin e veprimtarisë.

Në çdo rast të planifikimit të buxhetit financiar për realizimin e veprimtarive të planit afatmesëm, kur kontribuuesit janë nxënës, prindër apo ente publike, do të merret për referencë buxheti i planifikuar nga MAS për shpenzime të njëjta.

Në të gjitha rastet kur veprimtaritë e realizuara kanë mbështetje financiare, do të bëhet transparente nëpërmjet faqes së internetit dhe në mjediset e shkollës.

## VEPRIMTARITË KRYESORE, TREGUESIT E ARRITJEVE

| Prioriteti                                                                                                                                                                                                    | Objektiva dhe synime                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          | Veprimtarite qe do te zhvillohen                                                                                                                                                                                                                                                                          | Afati              | Ekipi pergjegjes               | Shënime |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------|--------------------------------|---------|
| Rritja e interesit të nxënësve për shkollën, dëshmuar me nivel më të lartë të frekuentimit të orëve mësimore dhe klubeve shkollore, si edhe uljes së numrit të nxënësve që largohen drejt shkollave të tjera. | Përqindja e nxënësve të paralajmëruar për përjashtim të mos jetë më shumë se 12 % (nga 13.3 % një vit më parë)<br>Përqindja e orëve vjetore të munguara nga nxënësit në raport me orët e zhvilluara, të mos jetë më shumë se 0.75 % (nga 0.81% një vit më parë)<br>Përqindja e braktisjes së mësimin nga nxënësit të mos jetë më shumë se 0.80 % (nga 0.84 % një vit më parë) | Ngritja dhe funksionimi i grupit të monitorimit të mungesave.                                                                                                                                                                                                                                             | Shtator 2022       | Drejtori                       |         |
|                                                                                                                                                                                                               |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               | Hartimi i instrumenteve vëzhgues dhe aplikimi i tyre.                                                                                                                                                                                                                                                     | Shtator 2022       | Grupi i monitorimit            |         |
|                                                                                                                                                                                                               |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               | Raportimi mujor në drejtori mbi situatën e frekuentimit të mësimin nga nxënësit.                                                                                                                                                                                                                          | Çdo fund muaji     |                                |         |
|                                                                                                                                                                                                               |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               | Përpunimi i bazës së të dhënave të nxënësve me qëllim komunikimin me prindërit.                                                                                                                                                                                                                           | Tetor 2022         | Mësuesit kujdestarë, drejtorja |         |
|                                                                                                                                                                                                               |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               | Hartimi dhe plotësimi i instrumenteve mbi mungesat ditore të nxënësve. Krijimi i ditarit fizik dhe digjital të mungesave të klasës. Ndjekja e mungesave të nxënësve përmes instrumenteve hardcopy dhe platformave digjitale (në rastet e mësimeve online për shkak të pandemisë apo fatkeqësive natyrore) | Shtator 2022       | Drejtorja, grupi i monitorimit |         |
|                                                                                                                                                                                                               |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |                                                                                                                                                                                                                                                                                                           | Plotësimi cdo dite | Mësuesit kujdestare            |         |

|  |  |                                                                                                                                                                                                                |                             |                                 |  |
|--|--|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------|---------------------------------|--|
|  |  | Kontakte të menjëhershme me prindërit/ kujdestarët e nxënësve të cilët braktisin orën e mësimit, komunikimi online me prindërit (kur mësimi zhvillohet online për shkak të pandemisë apo fatkeqësive natyrore) | Gjatë gjithë vitit shkollor | Sekretaria, mesuesit kujdestare |  |
|  |  | Trajnim i mësuesve për njohjen e nxënësve me probleme sociale.                                                                                                                                                 | Tetor 2022                  | Punonjesi psiko social          |  |
|  |  | Trajnim i nxënësve me probleme sociale mbi rëndësinë që ka shkolla dhe shkollimi                                                                                                                               | Vazhdimisht                 | Punonjesi psiko social          |  |
|  |  | Trajnim i prindërve të nxënësve me probleme sociale, mbi braktisjen e mësimit.                                                                                                                                 | Nentor 2022                 | Punonjesi psiko social          |  |
|  |  | Forcimi i bashkëpunimit midis institucioneve shkollë – NJMF – Policia e Shtetit.                                                                                                                               | Gjatë gjithë vitit shkollor | Punonjesi psiko social dhe OS   |  |
|  |  | Organizimi i garës mujore “Nxënësi që nuk mungon asnjë ditë në shkollë”.                                                                                                                                       | Cdo muaj                    | Drejtoria                       |  |
|  |  | Organizmi i garës semestrale “Klasa me 0 mungesa”.                                                                                                                                                             | Cdo fund periudhe           | Drejtoria                       |  |
|  |  | Shpërndarja e stimujve moralë nxënësve dhe klasave me rezultatet më të mira në frekuentim.                                                                                                                     | Cdo fund periudhe           | Drejtoria, donatoret            |  |

|  |  |                                                                                                                                                 |                           |                             |  |
|--|--|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------|-----------------------------|--|
|  |  | Vlerësimi i mësuesit kujdestar me performancën më të mirë në frekuentimin e mësimit nga nxënësit.                                               | Ne fund te vitit shkollor | Drejtoria                   |  |
|  |  | Organizimi i aktiviteteve argëtuese dhe sensibilizuese gjithëpërfshirëse në shkollë.                                                            | Gjatë gjithë vitit        | Drejtoria, bordi i shkolles |  |
|  |  | Punohen urdhrat, udhëzimet dhe rregulloret mbi procedurat e MSH                                                                                 | Sipas MAS                 | Drejtoria KSHMSH            |  |
|  |  | Trajnohen mësuesit mbi rregulloren dhe procedurat e MSH                                                                                         | Sipas MAS                 | KSHMSH                      |  |
|  |  | Trajnohen nxënësit për rregulloren dhe procedurat e MSH                                                                                         | Sipas MAS                 | KSHMSH                      |  |
|  |  | Trajnohen prindërit për rregulloren dhe procedurat e MSH                                                                                        | Sipas MAS                 | KSHMSH                      |  |
|  |  | Zbatohen dhe ndiqen procedurat e MSH                                                                                                            | Vazhdimisht               | Drejtoria, mësuesit, KSHMSH |  |
|  |  | Zhvillohet këshillimi i karrierës për nxënësit maturantë (në shkollë dhe online përmes platformave të ndryshme)                                 | Gjatë gjithë vitit        | Drejtoria, mësuesit, KSHMSH |  |
|  |  | Hartohet plani i monitorimeve të konsultimeve të MSH (në shkollë dhe online në rastet e zhvillimit të mësimit online për shkak të pandemisë apo | Shtator 2022              | Drejtoria                   |  |

|                                                                                                                                                                                                                            |                                                                                                                                                                          |                                                                                                                                                                |                       |                                            |  |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------|--------------------------------------------|--|
|                                                                                                                                                                                                                            |                                                                                                                                                                          | fatkeqësive natyrore)                                                                                                                                          |                       |                                            |  |
|                                                                                                                                                                                                                            |                                                                                                                                                                          | Hartohet grafiku i konsultimeve të MSH                                                                                                                         | Janar 2023            | Drejtoria                                  |  |
|                                                                                                                                                                                                                            |                                                                                                                                                                          | Zhvillohen konsultimet e MSH (në shkollë ose online)                                                                                                           | Janar – Maj 2023      | Drejtoria, mësuesit                        |  |
|                                                                                                                                                                                                                            |                                                                                                                                                                          | Monitorohen orët e konsultimeve                                                                                                                                | Janar – Maj 2023      | Drejtoria                                  |  |
|                                                                                                                                                                                                                            |                                                                                                                                                                          | Testohen nxënësit paraprakisht me modele testesh të MSH paraardhëse.                                                                                           | Maj 2023              | Drejtoria KSHMSH                           |  |
|                                                                                                                                                                                                                            |                                                                                                                                                                          | Asistohet në procedurat e përzgjedhjeve të formularëve të MSH.                                                                                                 | Gjatë gjithë vitit    | Drejtoria KSHMSH                           |  |
|                                                                                                                                                                                                                            |                                                                                                                                                                          | Analizohen rezultatet e arritura                                                                                                                               | Në fund të vitit      | Drejtoria KSHMSH                           |  |
| Përforcimi i imazhit të shkollës si institucion arsimor cilësor nëpërmjet arritjeve më të larta në aktivitetet konkurruese krahasuar me gjimnazet publike të ZVAP Fier dhe në rezultate më pozitive në provimet e maturës. | Të paktën 1 nxënës çdo vit të kalojë në fazën III të olimpiadave kombëtare<br>Të arrihet niveli më i lartë i fituesve në konkurrimet lokale sipas kartës së performancës | Sensibilizimi i hershëm i nxënësve për pjesëmarrje në olimpiada dhe konkurse<br>Promovim i vazhdueshëm i fituesve në hapësirën fizike dhe virtuale të shkollës | Gjatë vitit 2022-2023 | Drejtoria e shkollës<br><br>Grupet e punës |  |
|                                                                                                                                                                                                                            |                                                                                                                                                                          | Seanca përgatitore nga mësuesit e lëndës për                                                                                                                   | Gjatë vitit 2023-2024 | Drejtoria e shkollës                       |  |

|  |  |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |                       |                                            |  |
|--|--|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------|--------------------------------------------|--|
|  |  | konkurrentët nga shkolla jonë<br>Promovim i vazhdueshëm i fituesve në hapësirën fizike dhe virtuale të shkollës                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |                       | Grupet e punës                             |  |
|  |  | Hartimi dhe zbatimi i një plani për krijimin e klasave me nxënës të orientuar drejt lëndëve të olimpiadave, artit ose sportit që të zhvillohet në kurrikulën me zgjedhje (planifikohet fillimisht për klasën XII në maj-qershor 2020)<br>Promovim në një kënd të veçantë në shkollë i ishnxënësve të suksesshëm në aktivitetet kulturore e sportive të shkollës që në vitet e para të saj<br>Krijimi i klubeve të nxënësve sipas | Gjatë vitit 2024-2025 | Drejtoria e shkollës<br><br>Grupet e punës |  |

|  |  |                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |                       |                                                   |  |
|--|--|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------|---------------------------------------------------|--|
|  |  | prirjeve të tyre                                                                                                                                                                                                                                                                                            |                       |                                                   |  |
|  |  | <p>Funksionimi i klubeve të nxënësve sipas prirjeve të tyre</p> <p>Aktivitete ceremoniale për nxënësit e suksesshëm pas çdo fitoreje në olimpiada dhe takime sportive</p> <p>Bashkëpunim me shoqata dhe organizata të njohura për aktivizimin e talenteve të shkollës në veprimtari të nivelit kombëtar</p> | Gjatë vitit 2025-2026 | <p>Drejtoria e shkollës</p> <p>Grupet e punës</p> |  |